

VENDIM
Nr.58, datë 4.11.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datë 19.10.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.54 Akti, që i përket :

KËRKUESE: KONFEDERATA E SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË, e përfaqësuar nga Av.Haki Kraja, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR :

FEDERATA E SINDIKATAVE TË MINATORËVE, GJEOLÓGËVE DHE ENERGJITIKËS SË SHQIPËRISË, e përfaqësuar nga Kadri Isufaj, zv/kryetar i Federatës dhe avokat Syrja Dosti.

OBJEKTI:

Papajftueshmëria e vendimit nr.928, datë 30.6.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit me ligjin themelor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji shpjegimet e palës kërkuese, të subjektit të interesuar dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.928, datë 30.06.1998 ka vendosur prishjen e vendimit nr.29, datë 24.3.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes në atë gjykatë me arsyetimin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.45, datë 27.8.1997 në të cilin është bazuar në rigjykim Gjykata e Apelit, është antikushtetues. Sipas kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të shqyrtojë vendimet gjyqësore, sepse nuk ka norma juridike që të parashikojnë gjykimin e çështjeve nga kjo Gjykatë dhe se ajo nuk ka të drejtë të gjykojë sipas rregullave të përcaktuara për pushtetin gjyqësor. Po sipas asaj Gjykate, nëse Gjykata Kushtetuese i hyn shqyrtimit të një akti gjyqësor ajo mund të anullojë ose të shfuqizojë aktin e paligjshëm, por jo të rikthejë çështjen për rigjykim, sepse ndryshe nuk do të kemi zgjidhje përfundimtare të çështjeve që kërkon neni 24/9 i ligjit themelor.

Në radhë të parë theksojmë se, Gjykata e Kasacionit ka kompetencë të shqyrtojë bazën ligjore të vendimeve që i paraqiten në rrugë kundërshtimi, por nuk mund të bëjë interpretimin e Kushtetutës. Sipas nenit 24/1 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, interpretimi

i Kushtetutës dhe i ligjeve kushtetuese është prerrogativë e Gjykatës Kushtetuese. Duke u shprehur që “vendimi i Gjykatës Kushtetuese është antikushtetues sepse i atribuon vehtes kompetenca tej atyre të parashikuara në ligjin kushtetues”, kolegji civil bën interpretimin e ligjit kushtetues për kufijtë e kompetencave të një organi tjetër. Kjo në vetvete përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 24/9 të ligjit themelor ka për kompetencë të shqyrtojë ankesat e personave fizikë ose juridikë për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme. Me fjalën “akt” ligji themelor kupton jo vetëm aktet e organeve të tjera shtetërore, por edhe vendimet e gjykatave. Po të ishte ndryshe, për këto të fundit, ligji do të bënte përjashtim në mënyrë të shprehur. Fakti që nuk është shprehur është kuptimplotë, sepse nga kontrolli kushtetues nuk mund të përjashtohen as vendimet gjyqësore ndryshe këto akte do të mbeteshin të paprekura edhe kur janë në kundërshtim me ligjin kushtetues. Prandaj, Gjykata Kushtetuese mbron kushtetutën dhe nuk hyn në kompetencat e pushtetit gjyqësor kur me kërkesë të personave shqyrton shkeljen e të drejtave themelore, pra papajtueshmërinë ose jo të një vendimi gjyqësor me ligjin themelor. Në rastin konkret, kjo Gjykatë ishte e detyruar të shqyrtonte kërkesën e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë dhe pretendimet për cënimin e së drejtës së saj të pronës, e cila siç dihet, është e drejtë themelore.

Përsa i përket procedurës së shqyrtimit të kërkesave, vetë ligji nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, përmban disa norma procedurale (nenet 24, 25, 26), që kanë të bëjnë me legjitimitimin, me mënyrën e marrjes së vendimeve. Është e vërtetë që në nenin 28 të këtij ligji përcaktohet se organizimi e funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, e procedura e zgjidhjes së çështjeve të rregullohet me ligj dhe se ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, u miratua në 15 Korrik 1998, por mangësitë në disa norma të detajuara procedurale nuk mund të linin pa efekt juridik normat kushtetuese. Për më tepër, qysh nga krijimi i Gjykatës Kushtetuese në 29 prill 1992 e në vijimësi, janë deklaruar antikushtetuese jo pak vendime të gjykatave dhe këto të fundit kanë rigjykuar çështjet pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ky qëndrim ndryshohet pa argumenta bindëse juridike, madje në mënyrë antikushtetuese.

Sipas nenit 24/9 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, Gjykata Kushtetuese zgjidh përfundimisht ankesat e personave për shkeljen e të drejtave të tyre themelore. Zgjidhja përfundimtare këtu ka kuptimin në raport me të drejtën themelore, pra nëse ka apo jo shkelje të së drejtës dhe nëse kjo e drejtë është apo jo themelore, por nuk do të thotë aspak se Gjykata Kushtetuese duhet të zgjidhë edhe mosmarrëveshjet konkrete që rezultojnë midis personave nga shkelja e të drejtave të tyre themelore. Problemet konkrete do të zgjidhen nga gjykatat në bazë të normave procedurale e materiale. Prandaj, edhe çështja (dosja) u duhet dërguar atyre për shqyrtim. Me deklarinë antikushtetues të vendimit të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit mbetet pa zgjidhje ankesa e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë dhe nëse Gjykata Kushtetuese nuk do të dërgonte çështjen në Gjykatën e Kasacionit, do të cënonte të drejtat e tjera themelore të personit siç janë e drejta për apelim (neni 13), e drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 38), e drejta për një gjykim të drejtë e të shpejtë (neni 40) etj.

Në këto kushte, vendimi nr.928, datë 30.6.1998 i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit është antikushtetues dhe në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nuk sjell asnjë efekt juridik.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 26/1,2 të ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991

“Për dispozitat kryesore kushtetuese”, dhe nenit 41 të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Shpalljen antikushtetues të vendimit nr.928, datë 30.6.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, I formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.